

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
01	28/01/2022	Kërkesë për informacion mbi speciet e mbrojtura të faunës dhe florës, ardhur nga Komisariati i Policisë nr 1.	31/01/2022	Në përgjigje të kërkesës suaj ku na kërkoni informacion mbi speciet e mbrojtura të faunës po ju përcjellim listën e kuqe të florës dhe faunës miratuar me urdher ministri nr. 1280 datë 20.11.2013 i cili është ende në fuqi, ku shpendët përfshihen nga nr. 410-546 të saj. Sipas kësaj liste: 1. Lloji harabel i gurëve (Petronia petronia) është i përfshirë me nr. 526, por kërkohet interpretim nga specialistë të fushës (biolog) për të përcaktuar nëse bëhet fjalë për të njëjtin lloj. 2. Ndërsa lloji kumuri nuk është i përfshirë në këtë listë.	E plotë	Nuk ka
02	09/02/2022	Kërkesë për informacion mbi procedurat e regjistrimit dhe administrimin e zonave të mbrojtura, ardhur nga Bashkia Shkodër.		Trajtuar nga institucioni përgjegjës për Zonat e Mbrojtura	E deleguar	Nuk ka
03	17/02/2022	Kërkesë për informacion mbi regjistrimin e e pasurive pyje dhe kullota, ardhur nga Bashkia Shkodër	24/02/2022	Dhënë përgjigje nëpërmjet postës elektronike	E plotë	Nuk ka
04	26/04/2022	Kërkesë për informacion ardhur nga INSTAT, për të	04/10/2022	Në vijim të trajtimit "Mbi kërkesën për të dhënat administrative të vitit 2021" dhe dërgimin e informacionit për pyjet në INSTAT, nga Agjencia	E plotë	Nuk ka

		<p>dhënat administrative për vitin 2021.</p>	<p>Kombëtare e Pyjeve, Drejtoria e Menaxhimit të Pyjeve, Sektori i Inventarizimit dhe Kadastrës në pyje u plotësuan të dhënat sipas tabelave përkatëse dhe u dërguan elektronikisht në adresën zyrtare të INSTAT. Nga trajtimi i dokumentacionit në lidhje me informacionin "Për aktet e miratuara për heqjen nga fondi pyjor e kullor publik, për vitin 2021", referuar ndryshimeve të legjislacionit në fushën e pyjeve, kompetencat në administrimin, dhe përditësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor konstatojmë se:</p> <p>1- Përmbajtja e informacionit në dokumentacionin shoqërues "Për aktet e miratuara për heqjen nga fondi pyjor e kullor publik, për vitin 2021", nuk është i plotë dhe konkretisht:</p> <p>Mungojnë aktet ligjore "Urdhëri i Ministrisë", për 4 (katër) subjektet, shoqëria "Koxheri"shpk,aktivitet minerar, shoqëria "Vuthaj"shpk, aktivitet minerar shoqëria "Kroi Mbret Energji shpk, aktivitet ndërtim HEC dhe shoqëria "Lura Group"shpk, ndërtim kompleksi rezidencial dhe hoteleri.</p> <p>Mbështetur në kërkesat dhe përgjegjësitë që përcakton ligji nr.57/2020, datë 30/04/2020, "Për Pyjet", neni 15, pika 2, gërma "dh", VKM-ja nr.570, datë 17.07.2019, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, VKM-në Nr.171, datë 18.03.2022, Ngritjen e bazës së të dhënave për Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor dhe regjistrin e fondit kullor, përcaktimin e strukturës kritereve teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjëndjes dhe të ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal e qendror, informacionit që duhet regjistruar, si dhe të afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve", VKM-në</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>Nr.1353, datë 10.10.2008 "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", konstatohet se ka mungesë informacioni në dokumentacionin shkresor të dërguar pranë Agjencisë Kombëtare të Pyjeve si më poshtë: Mungojnë disa nga të dhënat parësore dhe dytësore që përfshihen në strukturën e Regjistrit Kombëtar të Fondit Pyjor, që përcaktohen në Shtojcën nr.1.sipas VKM-në Nr.171, datë 18.03.2022, Ngritjen e bazës së të dhënave për Regjistrin Kombëtar të Fondit Pyjor.... Mungojnë në dokumentacionin shkresor informacioni i plotë për sipërfaqen publike dhe private që ndryshohet destinacioni i gjithë nënparcelës pyjore apo një pjese sipas kërkesës të pikës 14, gërma "a" dhe "b", të VKM-së Nr.1353, datë 10.10.2008 Mungojnë në dokumentacionin shkresor informacioni që kërkohet sipas pikës 15, gërma "d", të VKM-së nr.1353, datë 10.10.2008.(Pozicionimi ku përfshihen, harta topografike, kordinatat gjeografike, planimetritë e sipërfaqeve që ndryshohet destinacioni) etj.</p>		
05	06/06/2022	Kërkesë për informacion dhe dokumentacion mbi një objekt shtetëror i ish "Zyrat e Pyjore" ardhur nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.	13/06/2022	<p>Në përgjigje të shkresës Tuaj "Kërkohet e përsëritur për informacion dhe dokumentacion", ju informojmë si më poshtë vijon se; Në mbështetje të vendimit nr.570, datë 17.07.2019 të Këshillit të Ministrave, "Per krijimin, organizimin dhe funksionin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve", Agjencia Kombëtare e Pyjeve peridhën në të cilën ka filluar veprimtarinë e vet ekzekutive është muaji shtator i viti 2020, dhe si e tillë aktualisht realizon kompetencat e veta në nivel qendror. Referuar këtij fakti, agjencia gëzon të drejtën e përdorimit vetëm mbi objektin në të cilin është</p>	E plotë	Nuk ka

				duke 27.03 2002 ushtruar veprimtarinë administrative. Për sa u tha më sipër, në përgjegjësi administrimi asete të tjera të llojit pasuri të paluajtëshme, me specifikime teknike përcaktuar në shkresën tuaj, AKP-ja nuk disponon.		
06	23/06/2022	Kërkesë për sqarim, lidhur me procedurat për inspektimin dhe mbrojtjen e pyjeve, adhur nga Bashkia Korçë.	05/07/2022	Duke ju referuar shkresës lidhur me kërkesën ju bëj me dijeni sa vijon: Agjencia Kombëtare e Pyjeve është institucioni qendror shtetëror përgjegjës për 05 2022 05 2022 mirëqeverisjen e pyjeve në nivel kombëtar. Përgjegjesitë e saj përcaktohen në pikën 2 të nenit 15 të ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020 "Për pyjet" dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 570, datë 17.07.2019 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve". Referuar përgjegjësive të përcaktuara në gërmat e dhe ë, të pikës 2 të nenit 15, të ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet", Agjencia Kombëtare e Pyjeve, kryen: 1. Mbikëqyrjen e zbatimit të kërkesave ligjore dhe të dokumenteve planifikuese në pyje, si dhe këshillimin e ndërgjegjësimit të aktorëve në lidhje me detyrimet për pyjet; 2. Garantimin e funksionalitetit të sistemit të kontrollit dhe të inspektimit të veprimtarive që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar, duke ndërhyrë sipas përcaktimeve në këtë ligj. Referuar pikave 5 dhe 6 të nenit 16, të ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet": Inspektorët e strukturave kontrolluese dhe inspektuese të pyjeve, në bashki, bazuar në natyrën e veçantë të funksionit që realizojnë kanë dhe përgjegjësinë e përbashkët për përmbushjen e tij, bashkëpunojnë me strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe monitorimin pranë agjencisë shtetërore përgjegjëse për pyjet. Referuar pikës 3	E plotë	Nuk ka

			<p>të nenit 34 të ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020 "Për pyjet":</p> <p>Funksioni i kontrollit ushtrohet nga:</p> <p>a) struktura përgjegjëse në agjenci,</p> <p>b) struktura përgjegjëse kontrolluese/inspektuese në bashki, c) struktura përgjegjëse në zonat e mbrojtura. Referuar pikës 4 të nenit 40 të ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet", "Agjencia në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror, unifikon praktikat për kontrollin dhe procesin e inspektimit në fondin pyjor kombëtar nga strukturat përgjegjëse në ushtrimin e kompetencave të tyre". Referuar shkronjave dh dhe e, të pikës 5.5, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 570, date 17.07.2019 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve", Agjencia Kombëtare e Pyjeve monitoron dhe kontrollon të drejtat e akorduara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore tek operatorët publikë ose privatë, për shfrytëzimin e fondit pyjor, për sa i përket përputhshmërisë dhe respektimit të kriterëve, të kërkesave, të kufizimeve dhe rekomandimeve të evidentuara në planet e menaxhimit e të mbarështimit të pyjeve, si dhe veprimtarinë e strukturave të administrimit e të inspektimit pyjor në njësitë e vetëqeverisjes vendore, për sa i përket zbatimit dhe respektimit të legjislacionit në fuqi e të planeve të miratuara, të cilat ndërhyjnë për marrjen e masave të detyrueshme në rastet kur evidentohen shkelje apo shmangie nga përmbajtja dhe kërkesat e tyre. Duke ju referuar pikës 8 të nenit 38, të ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet", "Procedura dhe vendimmarrja për dënimin dhe masat përkatëse, ankimi dhe ekzekutimi rregullohen nga legjislacioni në fuqi për kundërvajtjet</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>administrative dhe inspektimin. Përmbajtja dhe modelet e akteve për kundërvajtjet në pyje miratohen me urdhër të ministrit". Lidhur me sigurinë e pyjeve referuar pikës 3 të nenit 35 të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020 "Për pyjet", gjatë kontrolleve për parandalimin dhe hetimin e veprave penale në fushën e pyjeve, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit nëse mund të quhet si organ sigurie referuar legjislacionit në fuqi, mund të kërkojë dokumenta lidhur me një çështje të caktuar, si të gjithë subjektet e tjera juridiko publike e private, kur për këtë qëllim, si rregull këto dokumenta së pari duhet t'ja kërkojë subjektit, objekt i një procedimi. Për sa më lart, duke qenë se Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit nuk ka kompetenca lëndore të hetimit dhe procedimit administrativ sipas ligjit të posaçëm, nuk mund t'i vihet në dispozicion i gjithë dokumentacioni arkivor i bashkisë lidhur me kontratat e shfrytëzimit të fondit pyjor të lidhura nga bashkia, si dhe aktet e miratimit të heqjes nga fondi pyjor që disponohen nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe subjektet juridike përkatëse.</p>		
07	30/06/2022	Kërkesë për informacion mbi hartimin e planeve pjesore pyjore për zonat që kanë potencial për zhvillim, ardhur nga Bashkia Vau Dejës	08/07/2022	<p>Duke ju referuar kërkesës tuaj, lidhur me ligjshmërinë e hartimit të planeve pjesore të mbarështimit, ju bëj me dijeni sa vijon: "Mbarështimi i pyjeve" është planifikimi afatgjatë për pyjet, publike dhe private, i cili kryhet në bazë të kriterëve të caktuara për grumbullimin e informacionit për gjendjen faktike dhe përcaktimin e objektivave e masave të nevojshme, në funksion të statusit të dhënë, me synim përmbushjen e funksioneve ekologjike, ekonomike e sociale. Për sa më lart, çdo vendim që do merret nga ana e bashkisë në funksion të</p>	E plotë	Nuk ka

				hartimit të planeve pjesore të mbarështimit të pyjeve do të ishte i pavlefshëm, pasi bie ndesh me nenin 11 të ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020 "Për pyjet", si dhe paragrafet 1, 2 dhe 4 të Kreut III të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 438, datë 8.6.2016 "Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jo pyjore"		
08	19/08/2022	Kërkesë për informacion mbi sipërfaqet pyjore, parametrat dhe treguesit e gjëndjes dhe cilësisë së pyjeve, sipërfaqe të reja monitoruese përfaqësuese për cilësinë e pyjeve si dhe frekuencën e monitorimit të tyre, ardhur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.	03/10/2022	Në përgjigje të shkresës suaj, bazuar në ndryshimet dhe përditësimet e bëra nga ana jonë, bashkëlidhur po ju dërgojmë rrjetin e monitorimit për pyjet, listuar sipas treguesve të monitorimit dhe kriterëve pan- europiane për treguesit e gjëndjes së pyjeve. Në listën e paraqitur kemi veçuar vetëm sipërfaqet e monitorimit për pyjet duke qenë se sipërfaqet e monitorimit të biodiversitetit përcaktuar nga projekti "CEMSA" nuk kanë ndryshuar.	E plotë	Nuk ka
09	22/09/2022	Kërkesë për informacion ardhur nga subjekt privat, për informim mbi rregullat ligjore që duhet të operoj subjekti për tregtimin e materialit drusor dhe informimin kush është struktura kontrolluese inspektuese në fushën e pyjeve.	23/09/2022	Duke ju referuar kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dijeni sa vijon: Lidhur me aktivitetin ekonomik që do të zhvillohet, e konkretisht prodhimin dhe tregtimin e druve të zjarrit, duhet të zbatoni kërkesat e nenit 27 të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, "Për pyjet" dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 438, datë 8.06.2016, "Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore". Referuar pikës 3 të nenit 34 të ligjit nr. 57/2020, "Për pyjet", funksioni i kontrollit ushtrohet nga struktura përgjegjëse në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve dhe struktura përgjegjëse kontrolluese/inspektuese në Bashki.	E plotë	Nuk ka
10	27/10/2022	Kërkesë për informacion ardhur nga Emisioni	14/11/2022 Deleguar	Duke ju referuar kërkesës për informacion të Emisionit Piranjat, të kanalit televiziv ABC News,	E deleguar	Nuk ka

		Piranjat, Televizioni ABC, për disa të dhëna përsa i takon territorit të Qarkut Elbasan në fushën e pyjeve.	<ul style="list-style-type: none"> -Bashkisë Elbasan - Bashkisë Gramsh - Bashkisë Librazhd - Bashkisë Peqin - Bashkisë Prrenjas - Bashkisë Belsh - Bashkisë Cërrik 	<p>të datës 25.10.2022, drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, si dhe protokolluar në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve me nr. 986, datë 27.10.2022, kërkohet informacion nga bashkitë e qarkut Elbasan, referuar 7 pikave të shkresës bashkëlidhur të kërkuesit.</p> <p>Për sa më lart në mbështetje të legjislacionit në fuqi dhe në zbatim të kompetencave lëndore e përcaktuara në pikat 1/b dhe 2/ë, të nenit 35, të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, "Për pyjet", si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 570, datë 17.07.2019, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve", kërkojmë nga ana juaj dërgimin e informacionit "Emisionit Piranjat" brenda afatit ligjor, duke vënë për dijeni Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencinë Kombëtare të Pyjeve.</p>		
11	19/12/2022	<p>Kërkesë për informacion ardhur nga një gazetar i pavarur Freelance Journalist&Director:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kopje të Regjistrimit Kombëtar të fondit pyjor në vend. 2. Kopje të raporteve vjetore mbi gjendjen e fondit pyjor (për 2020 dhe për vitin 2021). 3. Kopje e raportit kombëtar të miratuar të pyjeve (Inventari). 		Në proces trajtimi	Në proces	Nuk ka
12						